

UNMIK/REG/2002/16
1 gusht 2002

RREGULLORE NR. 2002/16

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 2000/2 TË UNMIK-UT, TË NDRYSHUAR,
MBI AKCIZAT NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin e dhënë atij konform me Rezolutën 1244(1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh rregulloren no. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Pushtetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Rregullorja nr. 2001/9 e UNMIK-ut të datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores nr. 2000/2 të UNMIK-ut të 22 janarit 2000 mbi Akcizat në Kosovë dhe Rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2000/26 të datës 27 prill 2000, nr. 2000/35 të datës 16 qershor 2000, nr. 2000/56 të datës 6 tetor 2000, nr. 2001/15 të datës 3 korrik 2001 dhe nr. 2001/38 të datës 31 dhjetor 2001 për ndryshimin e Rregullores nr. 2000/2 të UNMIK-ut,

Duke vepruar me kërkesë të Qeverisë dhe pas konsultimit me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal në pajtim me nenin 8.1 (c) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme,

Shpall sa vijon:

Neni 1
Ndryshimi

Shtojca A e Rregullores nr. 2000/2 të UNMIK-ut, të ndryshuar, zëvendësohet me Shtojcën A të kësaj Rregulloreje.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 gusht 2002.

Michael Steiner
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

ANEKSI A

MALLRAT QË I NËNSHTROHEN AKCIZAVE DHE TARIFAT

Përshkrimi i mallrave	Shifra në sistem të harmonizuar	Tarifa e taksës
Kafja	0901	30% të vlerës
Pijet joalkoolike	2202	10% të vlerës
Birra e elbit	2203	0.15 euro për litër
Vera e rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara; lëngu i pafermentuar, pos atij të përfshirë në rreshtin nr. 20.09 Vermuthi dhe vera tjetër ose të rrushit të freskët të aromatizuar me bimë apo substanca aromatike	2204; 2205	0.20 euro për litër
Pijet e tjera të fermentuara (p.sh., sidër, raki dardhe, pije alkoolike nga fermentimi i mjaltit); përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijet joalkoolike, të paspecifikuara apo të papërfshira gjetiu	2206	0.15 euro për litër
Etil alkooli i padenatyrizuar i një fortësie alkoolike prej 80 % ose më lartë	2207	1 euro për litër alkool
Etil alkooli i padenatyrizuar i një fortësie më pak se 80 %; pijet alkoolike, likeret dhe pijet e tjera alkoolike	2208	1 euro për litër alkool
Cigaret	2402	2 euro për 1000 cigare
Cigaret puro, cigarillos dhe prodhimet e tjera të përpunuara të duhanit	2402 2043	50% të vlerës
Benzina	27100026; 27100027; 27100029; 27100032; 27100034; 27100036	30 centë për litër
Vaji për djegie	27100066; 27100068	27.5 centë për litër
Nafta për automjete (D1 + D2)	2710003100	27.5 centë për litër
Vajguri	2710051; 2710055	27.5 centë për litër
Vaji i ngrohjes	271000 4100; 271004900	27.5 centë për litër
Automobilët dhe automjetet, parimisht të disajnuara për transportin e personave (pos atyre që hyjnë në radhën nr. 8702), duke përfshirë automobilët e tipit karavan dhe automobilët e garave	8703	20% të vlerës + 500 euro secili